

BASHKIA TIRANË
KOMISIONI I VLERËSIMIT DHE NEGOCIMIT
THIRRJE E HAPUR

Komisioni i vlerësimit dhe negocimit i ngritur në mbështetje të ligjit 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", shpall thirrjen publike për realizimin e procedurës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Komisioni i vlerësimit dhe negocimit nëpërmjet kësaj thirrje fton te gjitha palët e interesuara të paraqesin propozimin e tyre për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës urbane të Teatrit Kombëtar përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar.

Referuar VKM-së Nr.352, date 04.04.2019 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit për vlerësimin dhe negocimin e kontratës, me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese për përzgjedhjen e palës private për realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e Kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar”, Komisioni i Vlerësimit dhe negocimit përcaktoi **Kriteret Kualifikuese** për palët private të interesuara sa më poshtë vijon:

1. Pala private e interesuar duhet të vërtetojë se përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 37/2018, si dhe plotëson të gjitha kërkesat minimale të projektimit sipas aneksit të VKM-së nr. 352, datë 04.04.2019.
2. Pala Private e interesuar dorëzon dokumentacionin që vërteton se:
 - a) nuk është në proces falimentimi,
 - b) nuk është dënuar për shkelje penale, sipas parashikimeve të legjislacionit për përgjegjësinë penale të personit juridik,
 - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit,
 - ç) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - d) ka paguar të gjithë detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore.
3. Pala private e interesuar duhet të ketë një xhiro vjetore shumatorja e të cilës për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 40% të vlerës së kostos së projektit të propozuar prej saj në këtë procedurë, duke e vërtetuar këtë me anë të vërtetimeve të lëshuara nga administrata tatimore si dhe me pasqyrat financiare të tre viteve të fundit.

4. Pala private e interesuar duhet të depozitojë të gjitha licensat profesionale dhe certifikimet e vlefshme, sipas aneksit 2 të VKM-së nr. 352, datë 04.04.2019.
5. Pala Private e interesuar duhet të vërtetojë realizimin e projekteve të ngjashme gjatë 5(pesë) viteve të fundit të aktivitetit të tij, shumatorja e të cilave të jetë jo më pak se 40% e sasisë ndërtimore (m2) totale të ofertuar prej tij në këtë procedurë në vijim të thirrjes së hapur. Realizimi i suksesshëm i punimeve duhet të vërtetohet me dokumentet, si më poshtë vijon:
 - a) leje ndërtimi ose kontratë sipërmarrje,
 - b) situacion përfundimtar,
 - c) akt kolaudimi,
 - ç) referenca nga punëdhënësi duke shprehur sasinë në m2 ndërtim të realizuar.
6. Pala private e interesuar duhet të paraqesi sigurimin e ofertës në nivelin e 2% të vlerës së kostos së projektit të propozuar prej tij në këtë procedurë në vijim të thirrje së hapur.
7. Pala e interesuar duhet të paraqesë analizën teknike, e cila duhet të përmbajë sfondin e projektit, konceptin e projektit, vendndodhjen, parcelat e prekura, sipërfaqen e përgjithshme publike e private të projektit, studimet topografike dhe gjeologjike, përshkrimin konstruktiv, funksional e teknik të projektit, ndikimet mjedisore dhe sociale, aksesueshmërinë nga automjetet dhe këmbësorët, periudhën e vlerësuar të ndërtimit të teatrit dhe analizën ekonomike e financiare.
8. Pala private e interesuar duhet të vërtetojë se është pronare e truallit ose posedon marrëveshjet përkatëse me pronarët privatë, minimumi në masën 40% e sipërfaqes totale të pronës private që preket nga projekti i zhvillimit të zonës dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar.
9. Kërkesat sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1, plotësohen me dorëzimin e ekstraktit të rregjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, ekstraktit mbi historikun e subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit mbi gjëndjen gjyqësore.
10. I gjithë dokumentacioni duhet të jetë i lëshuar jo më parë se 3(tre) muaj nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit nga palët private të interesuara (me përjashtim të pikave 4, 5, 7 dhe 9 të sipërcituara).
11. I gjithë dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar si dhe i shkruar në gjuhën shqipe (në rast se është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i shoqëruar me përkthimin përkatës në gjuhën shqipe nga një përkthyes i licensuar sipas legjislacionit në fuqi).

Gjithashtu informojmë se çdo palë private që kalon fazën kualifikuese, do të vlerësohet nga komisioni sipas **Kritereve Vlerësuese** në shumën totale 100 pikë, nga të cilat 70 pikë përbëjnë vlerësimi maksimal për Kriterin Teknik dhe 30 pikë përbëjnë vlerësimin maksimal për Kriterin Ekonomik të përcaktuara si më poshtë vijon:

1. Komponentët e kriterit teknik (totali 70 pikë)

a) Projektideja e zhvillimit të zonës (60 pikë), ku do të vlerësohen këto nënelemente:

i. masterplani, zgjidhja e ofruar (pesha 20 %):

Pala private do të vlerësohet në bazë të konceptit të projektit të paraqitur dhe tërësinë e ideve që gjenerojnë formën finale të objektit dhe të hapësirave përreth tij.

Projektideja do të vlerësohet mbi bazën e marrëdhënies dhe të ndërveprimit të pjesës së eksterierit me atë të interierit.

Planvendosja në terren e objekteve, duke marrë parasysh orientimin ndaj dritës, hijëzimin aty ku është e nevojshme, organizimin e sheshit.

Faza e projektimit skematik dhe konceptual e cila do të sigurohet nga Pala Private:

- koncepti i objektit;
- masterplani shkalle 1:500;
- aksesueshmëria nga Automjetet dhe Këmbësorët;
- genplan i përgjithshëm i objektit dhe sistemimet e jashtme, shkalla 1-500;
- skemë distributive, organizimi i hapësirave të Teatrit;
- planimetritë e Teatrit, të të gjitha kateve të propozuara e të mobiluar, shkalla 1 -200;
- të paktën 3 prerje A-A, shkalla 1-200;
- fasadat e objektit, shkalla 1 -200;
- të paktën 4 imazhe render të jashtme, 2 imazhe render të hapësirave të brendshme;
- të paktën 1 aksionometri volumetrike ose render.

ii. arkitektura e Teatrit Kombëtar (pesha 40 %):

Pala private do të vlerësohet duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Marrëdhënia me kontekstin urban dhe hapësirën publike;
- Marrëdhënia mes hapësirave të jashtme dhe hapësirave të brendshme;
- Sipërfaqja totale e Teatrit të Ri Kombëtar, duhet të jetë jo më pak se 8000 m² ndërtim, ku hapësira për shfaqjet të përbëhet nga 3 salla (me një auditorium kryesor me minimumi 600 vende, një sallë sekondare me një kapacitet prej 350 vendesh, si dhe një sallë eksperimentale (blackboX) me një kapacitet prej 150 vendesh;

iii. organizimi i brendshëm (pesha 40 %):

- Organizimi funksional dhe krijimi hapësirave për realizimin e “Produksioneve” (auditorium, hapësira për aktorët/për publikun, recepsion, foyer, auditori i hapur, auditoret e vogla si edhe të gjitha hapësirave mbështetëse, sallat e provave, punëtoritë, garderobën, hapësirat për dekorin, rekujziten, dhomat e aktoreve, zyrat e administratës, volumet ndihmëse të skenave, oxhaku i skenës, hapësirat për vendosjen e makinerive të skenës dhe nënskenës si dhe krijimi i funksionalitetit dhe harmonizimit të hapësirave të shfaqjeve me hapësirat ndihmëse për realizimin e produsioneve).
- Organizimi i brendshëm dhe orientimi i hapësirave të brendshme;
- Skema e qarkullimit për publikun dhe artistët;
- Aksesueshmëria nga Automjetet dhe Këmbësorët;
- Krijimi i “Hall of Fame” në ambientet e brendshme të Teatrit e cila duhet të jetë e karakterit muzeal dhe do të funksionojë për njohjen e publikut me traditën dhe historinë e Teatrit Kombëtar Shqiptar.

b) Niveli (në %) i gëzimit të të drejtave mbi pronën, referuar sipërfaqes totale të pronës private që preket nga projekti (5 pikë);

c) Koha e realizimit të ndërtimit (5 pikë).

2. Komponentët e kriterit ekonomik, i referohen ofertës për projektimin, ndërtimin, mobilimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin (totali 30 pikë)

- a) çmim kosto teatri për m2, sipas koston së projektit të propozuar (10 pikë);
b) sasia (në %) e propozuar për m2 pjesë takuese që do të përfitohet nga pala shtet (20 pikë).

Sqarojmë palët private të interesuara se pjesë e dokumentacionit të dorëzuar duhet të jenë dhe Licensat dhe Çertifikatat e përcaktuara në Aneksin 2 të VKM-së nr. 352, datë 04.04.2019 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit për vlerësimin dhe negocimin e kontratës, me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese për përzgjedhjen e palës private për realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e Kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar”, si më poshtë vijon:

1. Licenca Profesionale e Shoqërisë Ndërtuese, për realizimin e punimeve, sipas modelit të lëshuar nga Ministria përkatëse në kategoritë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 E Punime gërmimi në tokë
- NP- 2 G Ndërtime civile dhe industriale
- NP-12 G Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-1 E Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-3 C Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- NS-4 G Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- NS-8 F Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- NS-9 G Punime strukturore speciale
- NS-10 G Shtresa dhe mbistruktura speciale
- NS-12 D Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS-14 F Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS-18 D Punime topogjeodezike
- NS-20 C Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2. Licencë për Restaurimin e Monumenteve të Kulturës kategoria "c", lëshuar nga Ministria e Kulturës.

3. Licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKB-ja (Kodi III.2.A).

4. Licencë mbi grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuar nga QKB-ja (Kodi III.2.B).

5. Licenca profesionale për projektim (lëshuar nga ministria përkatëse), e vlefshme.

6. Pala private duhet të jetë e Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- ISO 9001-2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë);
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor);
- OHSAS 18001-2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë);
- ISO 39001-2012 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor).

Informojmë te gjitha palët e interesuara se evidentimi i sipërfaqeve në pronësi private si dhe në pronësi shtet për zonën të parashikuar për zhvillim, mund të tërhiqet pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia e Tiranës, duke filluar nga data e publikimit të thirrjes së hapur në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Sqarojmë palët e interesuara se propozimi për zhvillimin e projektit, duhet të përmbajë, minimalisht, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Analizën teknike, e cila duhet të përmbajë sfondin e projektit, konceptin e projektit, vendndodhjen, sipërfaqen e përgjithshme publike e private të zbatimit të projektit, studimet topografike dhe gjeologjike, përshkrimin konstruktiv, funksional e teknik të projektit, standardet teknike, periudhën e vlerësuar të ndërtimit të teatrit;
- b) Analizën ekonomike dhe financiare, e cila duhet të përmbajë kostot e projektit;
- c) Çdo dokumentacion tjetër, që do t'i shërbejë për kryerjen e negociatave;
- ç) Sigurimin e ofertës me 2% të vlerës së projektit të propozuar.

Palët private të interesuara mund të konsultohen me ligjin nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, si dhe vendimin nr. 352, datë 04.04.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin dhe negocimin e kontratës, me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese për përzgjedhjen e palës private për realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Dorëzimi i dokumentacionit duhet të kryhet brenda 60 ditësh dita e publikimit të kësaj thirrje në protokollin e Bashkisë Tiranë.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave : data 19.09.2019, Ora 14:00